REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 320/20
Data/Datum 04.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të Raportit*	*Nr. i lëndës:*
	29.05.2020	04.06.2020	320/20

1.NENI 105 i LPP-së, BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:21.05.2020, OE "ENG IDEA SHPK & SIB BKA SHPK" - Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: 320/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mbikëqyrja e punimeve konform të DSHP-së në Komunën e Prizrenit"**, me numër të prokurimit: 622-20-530-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit **(KP).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës:50,000.00 €.

Data e njoftimit për kontratë.....24.02.2020.
Data e hapjes së ofertës.....16.03.2020.
Data e njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.....04.05.2020.
Data e njoftimit të ofertuesve të papërgjegjshme.....04.05.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim "ENG IDEA SHPK & SIB BKA SHPK" .....08.05.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....14.05.2020.

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE DHE DISPOZITAT E SHKELURA

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

Neni 1 – Qëllimi;

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;

Neni 21/A – Ekonomizimi i aktivitetit të prokurimit;

Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Neni 60 – Kriteri për Dhënien e Kontratës;

Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve;

Neni 66 – Përshtatshmëria Profesionale;

Neni 68 – Gjendja Ekonomike dhe Financiare;

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

AK duke bere shkelje te dispozitave ligjore te larteshkruara me date 04.05.2020 ka derguar vendimin per anulimin e procedures se ketij tenderi. Njekohesisht eshte bashkangjitur edhe Letra standarde per tenderuesin e eleminuar ne te cilen eshte shkruar si ne vijim:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] **është administrativisht i papërgjegjshëm:**

Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 75.000,00 €

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë ingjinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion – Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. – Një ingjinjer i diplomuar ose master i elektros me jo më pak se tre vite përvojë pune në profesion – Një ingjinjer i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. – Një ingjinjer i diplomuar ose master i architekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. – Një ingjinjer i diplomuar ose master i gjeodezisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

– Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës.

Kërkesa 3.a. Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.

Konsiderojme se, AK (apo komisioni i vleresimit) ne kete leter ka marr me „copy" dhe pastaj „past" kerkesat e paraqitura ne dosjen e tenderit lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 dhe nuk ka dhene asnje arsyetim lidhur me ate se cili prej kritereve nuk eshte plotesuar nga grupi jone ofertues ENG IDEA shpk & Sib Bka shpk!

Kjo ka shty qe grupi jone ENG IDEA shpk & Sib Bka konform ligjit te prokurimit, neni 108 te kerkojme nga AK te rishqyrtoj vendimin e anulimit te tenderit dhe njeherit te marr parasysh dokumentacionin e derguar ne dosjen e tenderit nga Grupi jone ENG IDEA shpk & Sib Bka per te cilin dokumentacion mendojme ploteson cdo kerkese ne perputhje me kerkest tuaja ne FDT.

Ne vazhdim (ne kerkesen per rishqyrtim pran AK) kemi dhene te gjitha sqarimet nje nga nje lidhur me kerkesat dhe dokumentacionin e ofruar ne dosjen e tenderit.

Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 75.000,00 € .

Bashkangjitur deshmi:

Prezantimi i realizimit e projekteve per kompanine "ENG-IDEA" shpk

Kontrata te natyres se njejte

Nr.	Investitori	Personi kontaktues (tel., mob apo e-mail.	Emri i Projektit dhe vendi i parapar	Fillimi	Mbarimi	Shuma e kontraktuar sipas kontrates €
1	Komuna Istog	Jashar Bhlaj,ldu Menagjer I Kontrates 044 138 611	Mbiqqyrja e projekteve kapitale	Prill 2017	Dhjetor 2017	13,091.14 €
2	Spitali I pergjithshem "prim dr.Daut Mustafa" Prizren	Azem Kasniqi Menagjer I Projektit 044 269 481	Mbiqqyrja e punimeve , ndertimi I objektit per garazha te autoambulancave, arkives dhe salles se takimeve – faza II	Prill 2017	Tetor 2017	941.84 €
3.	Spitali I pergjithshem "prim dr.Daut Mustafa" Prizren	Azem Kasniqi Menagjer I Projektit 044 269 481	Mbiqqyrja e punimeve , ndertimi I objektit per garazha te autoambulancave, arkives dhe salles se takimeve – faza III	Tetor 2017	Mars 2018	966.61 €
4.	Spitali I pergjithshem "prim dr.Daut Mustafa" Prizren	Azem Kasniqi Menagjer I Projektit 044 269 481	Mbiqqyrja e punimeve , regullimi i hapesirave te gjelbenara dhe parkingjeve ne hapesirat e Spitalit	Maj 2017	Tetor 2017	795.74 €
3	Ministria e shendetesis	Arif Alimusaj Menagjer I Projektit 044 162 091	Mbiqqyrja profesionale e projektit : Ndertimi I Klinikes Emergjente ne QKUK	Maj 2016	Qershor 2019	49'648.83 €
4	Ministria e punes dhe mireqenies sociale	Luan Kastrati Menaxher I Projektit 044 527 109	Projektimi dhe mbikqyrja e projekteve	Tetor 2018	Vazhdon	120'000 € (vlera e kontrates) 15'000.0 € (te realizuara deri me tani mbiqqyrje)

Totali: 83,445.66 €

Prezantimi i realizimit e projekteve per kompanine "SIB-BKA" shpk

Kontrata te natyres se njejte

Nr.	Investitori	Personi kontaktues (tel., mob apo e-mail.	Emri i Projektit dhe vendi i ndertimit	Fillimi	Mbarimi	Shuma e investimit gjate realizimit €
1	Komuna Istog	Jashar Bhlaj,ldu Menagjer I Kontrates 044 138 611	Mbiqqyrja e projekteve kapitale ne Istog	Qershor 2018	Dhjetor 2018	12'949.21 €(
2	Ministria e shendetesis	Arif Alimusaj Menagjer I Projektit 044 162 091	Mbiqqyrja e punimeve – Riaftesimi i infrastruktures teknike dhe mbiteksture dhe pergatitje e platformes se hapesires se punimeve per ndertimin e Klinikes se pediatrise ne QKUK	Shkurt 2017	Nentor 2018	941.14 €
3	Ministria e shendetesis	Arif Alimusaj Menagjer I Projektit 044 162 091	Mbiqqyrja e punimeve ne projektin Adaptimi i hapesirave per Angiografi ne QKUK	Maj 2017	Shtator	967.32 €
4.	ACHRO sh.p.k	Visar Suhodolli 049 113 666	Mbiqqyrja profesionale e punove ndertimore per projektin e ndertimit te projektit per fabriken e prashitit te kromit ne Han te Elezit	Gusht 2018	Korrik 2019	18,000.0 €

Totali : 32'857.67 €

Vlera totale e projekteve te realizuara te natyres se ngjashme : 116,303.33 €

Date: 13/03/2020

ENG-IDEA" sh.p.k.
Drejtor
Heqir Ramadani

SIB-BKA sh.p.k
Drejtor
Sami Kolgeci

Te gjitha projektet e mbikqyrura jane te dokumentuara me kopje te kontratave, reference per perfundimin e sherbimit apo raport nga punedhenesi per perfundim te suksesshem te sherbimit.

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë ingjinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion

- Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.

I caktuar Beqir Ramadani ing. i dip. i ndertimtarise drejtimi konstruktiv pervoje pune 11 vite, Menagjer ne kontrata Mbikqyrje te projekteve shih CV , dhe referencat.

- Një ingjinjer i diplomuar ose master i elektros me jo më pak se tre vite përvojë pune në profesion

Ibrahim Elezi ing i elektros, 24 vite pervoje pune ne profesion

- Një ingjinjer i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

Burim Dula ing i dip. i hidros. 22 vite pervoje pune ne profesion

- Një ingjinjer i diplomuar ose master i architekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

Bujar Nela ing i dip. arkitekrures 35 vite pervoje pune ne profesion

- Një ingjinjer i diplomuar ose master i gjeodezisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

Lorenc Zani ing i gjeodezis 24 vite pervoje pune ne profesion

- Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës.

Bartesi i konsorciumit ENG IDEA shpk ka referenca te natyres se kontrates (mbikqyrje te projekteve) MBI vleren e kerkuar nga AK, pra 75,000.00 € < 83,445.66 € shih listen e puneve te kryera te natyres se njejte.

Kërkesa 3.a. Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.

Lista e stafit te angazhuar per kete kontrate eshte dhe po ashtu kontratat e të punësuarve, jane ne dokumentacionin e ofruar te tenderit ne forme elektronike dokumenti me emrin - 7. Stafi Profesional.

Lista e stafit profesional,te angazhuar ne kete kontrat						
Nr	Emri	Mbiemri	Profesioni	Mosha (Vite)	Pozicioni ne kompani	Eksperienca
1	Beqir	Ramadani	Ing.dip!.ndertimtaris-konstruktiv	45	Inxh.projektues,konstruktiv	10
2	Bujar	Nela	Ing.dipl.ark.	60	Inxh.projektues,ark.	35
3	Burim	Dula	Ing.dipl.ndertimtaris-hidro	49	Ing.dipl.ndertimtaris-hidro	22
4	Ibrahim	Elezi	Ing.dipl.elektroteknikes	58	Ing.dipl.elektroteknikes	23
5	Lorenc	Zani	Ing.dipl.gjeodezis	51	Ing.dipl.elektroteknikes	23

Menaxher I Kontratës: Ing.dipl.nder.Beqir Ramadani

Eng-Idea shpk

Sib-Bka sh.p.k

Marr parasysh kerkesat e dosjes se tenderit, krahasuar me dokumentacionin e dorezuar nga Grupi jone **ENG IDEA shpk & Sib Bka shpk** e kemi plotesisht te paqarte se cili nga keto kritere eshte konsideruar i paplotesuar nga AK!, per te shpallur te eleminuar si te papërgjegjshëm grupin tone? , e më pas të anuloj tenderin me arsyeshmerin se të gjithe ofertuesit nuk kane plotesuar kriteret!

Kemi kerkuar nga nga AK te merr parasysh ankesen per Rishqyrtim te vendimit per anulim, te anuloj vendimin per anulimin e tenderit dhe te vendos drejt ne perzgjedhejen e tenderuesit te suksesshem.

Megjithese, jane dhene sqarimet per te gjitha pikat nje nga nje AK - Komuna e Prizrenit me datë 14.05.2020 ka publikuar vendimin e AK duke vleresuar si te pabazuar kerkeseen tone per rishqyrtim edhe pse tani me „arsyet" per eleminimin e grupit tone e ka koncentruar tani me ne dy pika te kerkesave te dosjes se tenderit dhe ate me sa vijon:

> Autoriteti Kontraktues, me dat. 14. 05. 2020 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa për rishqyrtim të refuzohet si e pa bazuar për arsyet në vijim:
>
> 1. Autoriteti kontraktues me vëmendje ka rishiquar të gjitha kontratat dhe referencat e oofruara nga ana juaj edhe si OE edhe si Konsorcium dhe ka ardhë në konstatim se OE ENG Idea nuk ka referenca të mjaftueshme në vlerën e 60 % të totalit të referencave të kërkuara si dhe Konsorciumi nuk ka vlerën e kërkuar të referencave prej 75.000,00 euro.
> 2. Në Dëshmitë mbi aftësitë teknike dhe profesionale është kërkuar dëshmitë mbi ekspertët e kërkuar si dhe lista e stafit e dëshmuar me kontratat e punës ose bashkëpunimit për këtë projekt
>
> Ju keni ofruar listen e ekspertëve të kërkuar por nuk keni ofru listën e stafit prej 5 të punësuarish të përcjellë me kontratat të punës ose kontrata të bashkëpunimit për këtë projekt

Pretendimi 1: sa i perket arsyeshmeris se AK te paraqitur ne kete pike eshte plotësisht e paqendrueshme sespse bartesi i konsorciumit ENG IDEA shpk ka realizuar punime te ngjashme konkretisht mbikqyrje profesinale ne pune ndertimore per periudhen e tri viteve te fundit 2017, 2018, 2019 hiq me pak se 83,444.66 € - 9929.61 € =73,515.05 €. Vlera prej 9,929.61 € është vlera e pjesshme e sherbimit (realizuar ne vitin 2016) mbikqyrje profesionale qe eshte bere ne kuader te kontrates me titull: Mbikqyrja profesionale e projektit Ndertimi i klinikes emergjente ne QKUK kontrate me Ministrin e Shendetesis. Per kete arsye dhe e kemi zbritur nga totali prej 83,444.66 per te qene edhe me te qartë.

Përveq kësaj, parteneri Sib Bka shpk ka realizuar punime ne sherbime- mbikqyrje ne tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019 ne vlere prej 32,857.67 €. Pra, vlera e pergjithshme e punimeve te realizuar nga grupi jone i OE Eng Idea shpk & Sib Bka shpk kap vleren prej 116,303.33 €.

Për të gjitha këto sherbime eshte përgaditur lista e shërbimeve të kryera duke specifikuar sakt emrin e kontratave, Autoritetet kontraktuese, numrat e kontaktit te punedhenesve, vlera e kostos se sherbimeve dhe periudha e realizimit te sherbimeve. Po ashtu, ne dosjen e tenderit jane dorezuar kontratat dhe referencat apo proceverbalet - raportet e pranimit të ketyre shërbimeve nga Autoritetet Kontraktuese respektive.

Pretendimi 2: sa i perket pikes dy te arsyeshmeris se AK duhet te lexojme me kujdes kerkesen ne FDT piken mbi aftesit teknike dhe profesionale Deshmit e kerkuara:

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë ingjinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion – Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. – Një ingjinjer i diplomuar ose master i elektros me jo më pak se tre vite përvojë pune në profesion – Një ingjinjer i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. – Një ingjinjer i diplomuar ose master i architekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. – Një ingjinjer i diplomuar ose master i gjeodezisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.
– Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës.

Dëshmija 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. Dëshmi mbi kualifikimin e stafit professional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën, kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë project.

Kërkesa 3.a. Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.
Dëshmija 3.a. Lista e të punësuarve , përshkrimi I shkurtër I vendit të punës për stafin e rregullt kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.

Për çudi, AK në arsyeshmerin e derguar ne Vendimin per refuzim të kërkesës për rishqyrtim vendos termin „është kërkuar dëshmitë mbi ekspertët e kërkuar si dhe lista e stafit e dëshmuar me kontratat e punës ose bashkëpunimit për këtë projekt", ***mirëpo kerkesa 2.a potencon qartë:*** **„ Në kuadër të stafit.....** ***e as te Deshmia 2 nuk permendet ne asnje vend termi „ekspert"!?***

Kurse Kerkesa 3.a qartë e potencon që të ketë së paku 5 *(korrespodon sakt me numrin e stafit te kerkuar kerkesa 2)* të punësuar të profileve të ndyshme adekuate (fjala „adekuat" qartesohet vetem ne kerkesen 2 sepse nuk ka asnje reference tjeter) , Deshmia 3a shenon Lista e te punesuarve qe eshte fjala per stafin e rregullt dhe stafin e ri me kontrat bashkepunimi (qe lidhet sakt me kerkesen 2 ku shkruan „ Ne kuader të stafit) !?

Nisur nga kerkesat ne FDT sa i perket kesaj pike, deshmive te lartecekura ne kerkesen për rishqyrtim që eshte e pershkruar me siper, bashkangjitur dhe kopjet e deshmive te ofruara AK permes e-prokurimit ne fazen e tenderimit nuk ka asnje pike e kerkesave-Deshmive qe nuk eshte plotesuar nga grupi i OE Eng Idea shpk & Sib Bka shpk.

Prandaj, kërkojme nga OSHP që lënda të kthehet në rivlerësim për faktin se AK përveq se eleminon grupin tonë për një pikë që plotësohet në tërësi, elemenimin në pikën e dytë e mbështet në një kërkesë e cila nuk ekziston në dosjen e tenderit dhe eshte ne kundershtim me nenin 56.3 te LPP-se, sepse lidhur me stafin e të punësuarve kemi ofruar, kontratat, vendimin per menagjerin, CV-it e stafit, sipas kerkeses se dosjes se tenderit, e po ashtu kemi bashkangjitur listen e stafit te angazhuar ne rast të kontraktimi te kesaj kontrate- sherbimi, liste ne te cilen ne perputhje me kerkesen Deshmija 3.a. jane paraqitur stafi profesional me emer e mbiemer, pergaditjen shkollore-kualifikimin, pozicionin ne kete oferte, eksperienca e tre profesionale ne vite, kontratat e punes per punetoret e rregllt dhe parakontratat per stafin e jashtem!

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET – KRITERET PËR VLERËSIM

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Kërkesat a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës d një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *a. Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vuloset në origjinal b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). D. Vërtetimi i tatimit në pronë Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorzimë të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar*
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3 Certifikata e TVSH së*
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 100.000,00 €	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Krekës 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara*

OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 75.000,00 €. Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. - Një inxhinier i diplomuar ose master i elektros me jo më pak se tre vite përvojë pune në profesion - Një inxhinier i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. - Një inxhinier i diplomuar ose master i architekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. - Një inxhinier i diplomuar ose master i gjeodezisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. - Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës. Kërkesa 3.a. Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës	*me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.* *Dëshmia 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. Dëshmi mbi kualifikimin e stafit profesional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën, kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë project. Dëshmia 3.a. Lista e të punësuarve, përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.*

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pasi ka analizuar ofertat, duke marr parasysh të gjitha kërkesat e FDT-së, për këtë lende, rekomandon ZP që të anuloj aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Ky rekomandim i komisionit vlerësues është aprovuar dhe është bërë Njoftimi mbi vendimin e AK-së me 04.05.2020.

Operatori ekonomik ankues "ENG IDEA SHPK & SIB BKA SHPK" - Prizren, ka ofertuar në vlerë totale të ofertës:1,45€.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE "ENG IDEA SHPK & SIB BKA SHPK" – PRIZREN.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: *"Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 75.000,00 €"*, dhe Dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve"*. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "ENG IDEA SHPK & SIB BKA SHPK", konkretisht lideri i konsorciumit "ENG IDEA SHPK", nuk e përmbush minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës, për më tepër ju ofrojmë listën e projekte, referencat dhe raportet e pranimeve përfundimtare.

Prezantimi i realizimit e projekteve per kompanine "ENG-IDEA" shpk

Kontrata te natyres se njejte

Nr.	Investitori	Personi kontaktues (tel., mob apo e-mail.	Emri i Projektit dhe vendi i parapar	Fillimi	Mbarimi	Shuma e kontraktuar sipas kontrates €
1	Komuna Istog	Jashar Blakaj,idn Menagjer I kontrates 044 138 611	Mbikqyrja e projekteve kapitale	Prill 2017	Dhjetor 2017	13,091.14 €
2	Spitali I pergjithshem "prim dr.Daut Mustafa" Prizren	Azem Krasniqi Menagjer I Projektit 044 269 481	Mbikqyrja e punimeve , ndertimi I objektit per garazha te autoambulancave, arkives dhe salles se takimeve – faza II	Prill 2017	Tetor 2017	941.14 €
3.	Spitali I pergjithshem "prim dr.Daut Mustafa" Prizren	Azem Krasniqi Menagjer I Projektit 044 269 481	Mbikqyrja e punimeve , ndertimi I objektit per garazha te autoambulancave, arkives dhe salles se takimeve – faza III	Tetor 2017	Mars 2018	966.61 €
4.	Spitali I pergjithshem "prim dr.Daut Mustafa" Prizren	Azem Krasniqi Menagjer I Projektit 044 269 481	Mbikqyrja e punimeve , rregullimi i hapesirave te gjelbruara dhe parkingjeve ne hapesirat e Spitalit	Maj 2017	Tetor 2017	798.74 €
3	Ministria e shendetesis	Arif Alimusaj Menagjer I Projektit 044 162 094	Mbikqyrja profesionale e projektit : Ndertimi I Klinikes Emergjente ne QKUK	Maj 2016	Qeshor 2019	49'648.03 €
4	Ministria e punes dhe mireqenies sociale	Luan Kastrati Menaxher I Projektit 044 527 109	Projektimi dhe mbikqyrja e projekteve	Tetor 2018	Vazhdon	120'000 € (vlera e kontrates) 18'000.0 € (te realizuara deri me tani mbikqyrje)

Totali: 83,445.66 €

Prezantimi i realizimit e projekteve per kompanine "SIB-BKA" shpk

Kontrata te natyres se njejte

Nr.	Investitori	Personi kontaktues (tel., mob apo e-mail.	Emri i Projektit dhe vendi i ndertimit	Fillimi	Mbarimi	Shuma e investimit gjate realizimit €
1	Komuna Istog	Jashar Blakaj,idn Menagjer I kontrates 044 138 611	Mbikqyrja e projekteve kapitale ne Istog	Qeshor 2018	Dhjetor 2018	12'949.21 €(
2	Ministria e shendetesis	Arif Alimusaj Menagjer I Projektit 044 162 094	Mbukqyerja e punimeve – Dislokimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokesore dhe pergatitje e platformes se hapesires se punimeve per ndertimin e klinikes se pediatrise ne QKUK	Shkurt 2017	Nentor 2018	941.14 €
3	Ministria e shendetesis	Arif Alimusaj Menagjer I Projektit 044 162 094	Mbikqyrja e punimeve ne projektin Adaptimi i hapesirave per Angiograf ne QKUK	Maj 2017	Shtator	967.32 €
4.	ACHRO sh.p.k	Visar Suhodolli 049 113 666	Mbikqyrja profesionale e puneve ndertimore per projektin e ndertimit te projektit per fabriken e pasurimit te kromit ne Han te Elezit	Gusht 2018	Korrik 2019	18,000.0 €

Totali : 32'857.67 €

Vlera totale e projekteve te realizuara te natyres se ngjashme : 116,303.33 €

Datë: 13/03/2020

ENG-IDEA" sh.p.k
Drejtor
Beqir Ramadani

SIB-BKA sh.p.k
Drejtor
Sami Kolgeci

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opstina Istok
Municpalty of Istog

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
Direkcija za Ekonomiju i Razvoj
Directory Economy and Development

DATË/A:	04.01.2018
REFERENCË:	01/2018
PËR/ZA/TO:	N.P.N. ENG-IDEA & SIB BKA - Suharekë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim Jashar Blakaj
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	REFERENCË

Me kërkesë te Operatorit Ekonomik **N.P.N. ENG-IDEA & SIB BKA** me seli ne Suharekë me NRB 70693119, te datës 04.01.2018, nr.pr. 04-016-635, Komuna e Istogut me anë të këtij dokumenti dëshmon, për të gjitha palët e interesuara, se **N.P.N. ENG-IDEA & SIB BKA** nga Suhareka, gjatë vitit 2017 ka përfunduar më sukses :

"Mbikëqyrja e projekteve kapitale"

Emërtimi i kontratës	Vlera e projekteve te mbikëqyrura (Euro)	Shuma e paguar sipas kontratës (Euro)	Numri i kontratës
"Mbikëqyrja e projekteve kapitale"	2,077,959.97	13,091.14	633-17-7132-2-1/FA001 633/017/011/211

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 06
Nr. Prot: / Broj Prot: / Prot No 05-6788
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -180-
Data: / Datum / Date: 27/11/2019
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health
Departamenti për Menaxhim Strategjik/Departman za Stratesko Menadiranje/Department for Strategic Management

DATË/DATA :	26.11.2019
PËR/ZA/TO:	**Z. Ismet Hyseni – Udhëheqës i ZP MSH,**
PERMES/PREKO/THROUGH	
CC:	Dr. Naim Bardiqi – Sekretar i Përgjithshëm MSH z. Isak Shabani – u.d. Drejtor i DZHSSH MSh z. Jahë Gecaj – Drejtor i DA MSh
NGA/OD/FROM:	z. Arif Alimusaj –Menaxher i Kontratës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Rekomandim - për Pagesën e Shërbimit te Mbikëqyrjes për projektin: "Mbikëqyrja profesionale e projektit: Ndërtimi i Klinikes Emergjente ne QKUK"** **Kontrata nr. 206/15/013/211**

I nderuari z. Hyseni:

Bazuar ne:

- Raport final – Shkresa nr. 05-6435, dt. 12.11.2019 (ne bashkëngjitje),
- Kontrata: nr. 206/15/013/211, me titull: "Mbikëqyrja profesionale e projektit: Ndërtimi i Klinikes Emergjente ne QKUK". Neni: 6.4 (Kushtet e Veçanta),
- Situacion i pagesës Nr.3 (nga mbikëqyrësi), dt. 25.11.2019,
- Fatura nr. 06/19, dt. 25/11/2019, ne vlerën prej: 25.568,73 €,

Rekomandoheni te bëni pagesën e shërbimit te mbikëqyrjes në shumen prej: 25.568,73 €.

Ne Bashkëngjitje keni edhe:

- Deklarata e pronarit te ndërmarrjes mbikëqyrëse "Eng Idea" shpk, dt. 08.11.2019,
- Certifikata e biznesit nga ndërmarrja mbikëqyrëse "Eng Idea" shpk,
- Raport final – Shkresa nr. 05-6191, dt. 04.11.2019 (ne bashkëngjitje),
- Raporti mbi kryerjen e punimeve – mbikëqyrja, dt. 18.09.2019,
- Tabela mbi ditët e shfrytëzuara – mbikëqyrja, dt. 11.09.2019
- Kontrata: nr. 206/15/013/211, me titull: "Mbikëqyrja profesionale e projektit: Ndërtimi i Klinikes Emergjente ne QKUK",
- Ditari i punimeve – mbikëqyrja ne vitet: 2016; 2017; 2018 dhe 2019,

Me Respekt,

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, General Hospital, Opšta Bolnica, Genel Hastane
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" - Prizren

RAPORT PERFUNDIMTAR

Për: Zyren e Finacave, mbikqyrsin "ENG-IDEA" N.P.N

Lenda: Mbikqyrja e punimeve

Projekti: NDERTIMI I OBJEKTIT PËR GARAZHA TË AUTOAMBULANCAVE, ARKIVËS DHE SALLËS SË TAKIMEVE" – (Faza e dytë)

Nga: Azem Krasniqi, menaxher i projektit,

Dat: 14.08.2017

Nr. Indentifikimit: nr. 7001017051247

Çmimi total : 941.14 €

Kontraktori: "ENG-IDEA" N.P.N – Suharek

Mbikqyreja është kryer nga "ENG-IDEA" N.P.N

Raportoi se kompania mbikqyrese ka kryer ne tersi projektin "NDERTIMI I OBJEKTIT PËR GARAZHA TË AUTOAMBULANCAVE, ARKIVËS DHE SALLËS SË TAKIMEVE" – (Faza e dytë"

Une si menaxher kontrate jam i knaqur me bashkpunimin profesjonal te cilen ka ofruar kompania mbikqyres, "ENG-IDEA" N.P.N

O.E. "ENG-IDEA" N.P.N deri ne diten e pranimit teknik dt. 11.07.2017 ka dorzuar te gjitha raportet, procesverbalet, librat ndertimor dhe ditaret ndertimor te korigjuar ne menyr porfesjonale.

Konstatoi se organi mbikqyres ka perfunduar punen sipas kontrates se lidhur me instutucionin tone.

Përgjegjës i Shërbimeve Teknike & IT- ës
Msc. Ing. dip. Azem Krasniqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
SPITALI PERGJITHSHEM - OPSTA BOLNICA- GENEL HASTANESI "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren

Data/ Date/Datum	28.02.2017	Ref.No 813
Për/To/Za	" N.P.N"Eng Idea - Suharekë	
Përmes/Through/Preko	Arhivës	
Lënda/Subject/Tema:	Referencë	
Nr. Prokurimit	70010/ 16 /051 / 247	

Në bazë të kërkesës së OE – " N.P.N"Eng Idea - Suharekë, "Spitali i Pergjithshem "prim.dr.DAUT MUSTAFA" në Prizren lëshon këtë:

REFERENCË

Spitali i përgjithëshem në Prizren është i kënaqur me bashkëpunimin me OE *"N.P.N" Eng Idea - Suharekë* është kompania e cila ka bërë mbikqyrjen e punimeve në : ***"Mbikqyrja e punimeve Ndertimi –Renovimi i fasadave brenda dhe jashtë kulmeve,terasave dhe ndarjeve te hapsirave neper repartet e spitalit "*** **vlera financiare për këtë tender është prej 981.62 € e vleres totale te kontrates**. për të cilin spitali i Prizrenit është i kënaqur me obligimet e dalura nga kontrata dhe kualiteti i mbikqyrjeve për punimet e realizuara, për ***Mbikqyrja e punimeve Ndertimi –Renovimi i fasadave brenda dhe jashtë kulmeve,terasave dhe ndarjeve te hapsirave neper repartet e spitalit "*** Prej startimit të bashkpunimit me këtë kompani jemi të kënaqur me mbikqyrjet e punimeve të kryera dhe se asnjeherë deri më tani nuk kemi pasur rast të reklamimit për Mbikqyrjet e punimeve të kryera nga kjo kompani.

Menaxheri i prokurimit
Jur.dipl. Sami Abdullai

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: *Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinier I diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.*

- Një inxhinier i diplomuar ose master i elektros me jo më pak se tre vite përvojë pune në profesion
- Një inxhinier i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.
- Një inxhinier i diplomuar ose master i architekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.
- Një inxhinier i diplomuar ose master i gjeodezisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

Si dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. Dëshmi mbi kualifikimin e stafit profesional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën, kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë Project".*

Kërkesa 3.a: "Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës".

Dëshmia 3.a. *"Lista e të punësuarve, përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt".*

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se për stafin profesional, OE ankues "ENG IDEA SHPK & SIB BKA SHPK", i ka ofruar të gjitha dëshmitë ashtu siç janë kërkuar.

Lista e stafit profesional,te angazhuar ne kete kontrat						
Nr	Emri	Mbiemri	Profesioni	Mosha (Vite)	Pozicioni ne kompani	Eksperienca
1	Beqir	Ramadani	Ing.dipl.ndertimtaris-konstruktiv	45	Inxh.projektues,konstruktiv	10
2	Bujar	Nela	Ing.dipl.ark.	60	Inxh.projektues,ark.	35
3	Burim	Dula	Ing.dipl.ndertimtaris-hidro	49	Ing.dipl.ndertimtaris-hidro	22
4	Ibrahim	Elezi	Ing.dipl.elektroteknikes	53	Ing.dipl.elektroteknikes	23
5	Lorenc	Zani	Ing.dipl.gjeodezis	51	Ing.dipl.elektroteknikes	23

Menaxher i Kontrates: Ing.dipl.nder.Beqir Ramadani

Eng-Idea sh.p.k.

Sib-Bka sh.p.k.

13.03.2020

Ndërsa sa i përket kërkesës: *"Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës", mendoj se kjo kërkesë nuk është e sqaruar se pesë (5) të punësuarit të cilëve profile duhet të jenë, andaj si i tillë ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar.*

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi mi anulimin e aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prizrenit (KP).
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "ENG IDEA SHPK & SIB BKA SHPK".